

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE Majlinda E. Demollari

Nr 1040 Rep

Nr 679 Kol

Majlinda E. Demollari
Taksa e Pulles
U Pagua

**STATUT E AKTHEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" Macom " shpk**

Sot me date 13.03, te vitit 2018 (dymije e tetembdhjete), perpara meje, Majlinda E. Demollari Noter Publik, anetar i Dhomes se Noterise Publike Tirane, me zyre te regjistruar ne Rrugen " Vaso Pasha ", u paraqit personalisht:

Marin Gjonaj, i biri Besnikut, i datelindjes 30/08/1985, lindur e banues ne Tiranë, identifikuar sipas ligjit me letërnjoftimin ID me nr personal I50830192B, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

I cili eshte ortak themelues te Shoqerise " **Macom** " shpk dhe me aprovim ketij Statutit dhe akthemelimi sipas termave dhe kushteve si me poshte vijon:

TITULLI I

EMRI I SHOQERISE - REGJIMI JURIDIK - SELIA - KOHEZGJATJA

NENI 1 - Emri i Shoqerise

- 1.1 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, eshte krijuar Shoqeria " **Macom** " shpk ne vijim referuar si "Shoqeria".
- 1.2 Shoqeria ka logon dhe vulen e vet zyrtare.

NENI 2 - Regjimi Juridik i Shoqerise

- 2.1 " **Macom** " shpk eshte nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.
- 2.2 Aktiviteti i saj eshte i organizuar sipas dispozitave te Statutit dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil ne Republiken e Shqiperise.
- 2.3 Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mund te ndryshoje regjimin e saj juridik, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe dispozitat e Statutit te saj.
- 2.4 Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.

NENI 3 - Selia

- 3.1 Shoqeria ka seline e saj ne adresen: Rr" Dora D.istria" pall Teknoproject, kati i dyte, Tirane Shqiperi.
- 3.2 Shoqeria mund te hape ose te mbylle dege, filiale dhe / ose zyra perfaqesimi brenda Shqiperise dhe / ose jashte vendit, ose te krijojte shoqeri te tjera me Partnere apo Aksionare pjesemarres.

NENI 4 - Kohezgjatja

- 4.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Ortaku i Shoqerise mund te vendosi te kufizojte kohezgjatjen e aktivitetit me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme.

TITULLI II



TITULLI II

OBJEKTI

Neni 5 - Objekti

5.1 Shërbime hotelerie, real estate, ndërtimi banesash familjare ose biznesi, konsulence biznesi në real estate/telekomunikacion/hoteleri etj, agjensi shitjesi dhe blerjesh me shumice të produkteve apo shërbimeve të ndryshme.

TITULLI III

KAPITALI I SHOQERISE - TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT

Neni 6 – Kapitali i Shoqerise

6.1 Kapitali i shoqerise do të jetë 100.000,00 Lekë, i përbërë nga 1 kuota me përqindje në pjesëmarrje 100,00 i zotëruar nga ortakët i vetëm i saj me vlerë nominale Lek. 100.000,00 që përfaqësojnë 100 % të kapitalit;

Neni 7 - Transferimi i kuotave

7.1 Transferimi i kuotave të shoqerise ndaj paleve të treta i nënshtrohet së drejte së parablerjes në favor të ortakëve të tjerë të cilët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë sipas kushteve të përcaktuara në nenin 7.2 deri në nenin 7.6 më poshtë.

7.2 Në rast se një ortak "Ofruesi" kërkon të shesë dhe/ose të transferojë disa ose të gjitha kuotat e tij, ortakët e mbetur ("Ortakët e mbetur") do të kenë të drejtën e parablerjes në lidhje me kuotën që ofrohen për transferim ("Kuota e ofruar"), sipas kushteve të mëposhtme:

(a) Ofruesi do të dërgojë fillimisht ortakëve të mbetur një njoftim me shkrim i cili përcakton përqindjen e kuotës së ofruar, cmimin dhe kushtet e tjera të transferimit të cilat duhet të përshijne Identitetin e Blerësit ("OFERTA"), duke ftuar së pari Ortakët e mbetur të blejnë aksionet e ofruara;

(b) Ortakët e mbetur do të kenë të drejtën të blejnë kuotat e ofruara përpjestimisht dhe sipas kushteve të ofertes, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një afati prej tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së njoftimit të Ofruesit.

7.3 Në rast se më shumë se një prej Ortakëve të mbetur dëshirojnë të blejnë kuotën e ofruar, secili prej këtyre ortakëve të mbetur do të ketë të drejtën të blejë kuotën e ofruar përpjestimisht sipas përqindjeve që zotërojnë në Shoqeri, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh nga marrja e njoftimit sipas së cilit secili prej tyre dëshiron të blejë kuotën e ofruar.

7.4 Në rast se asnjë nga ortakët e mbetur nuk dëshiron të blejë kuotën e ofruar dhe/ose kanë refuzuar të blejnë kuotën e ofruar, sipas kushteve të përcaktuara këtu, brenda tridhjetë ditëve nga marrja e këtij njoftimi, Ofruesi do të ketë të drejtën të transferojë Kuotat e ofruara një pale të tretë me të njetin cmim që i është ofruar ortakëve të mbetur (sipas kushteve të ofertes fillestare). Nëse ky kusht nuk është përmbushur, Marrëveshja për Shitjen e Kuotave me palët e treta do të jetë e pavlefshme.

7.5 Në rast se ndonjë ose të gjithë ortakët e shoqerise blen/blejnë kuotat e ofruara sipas kushteve të ofertes, sic përcaktohet më sipër, ky transferim do të kryhet sipas kushteve të ofertes.

7.6 Kushtet e parashikuara më sipër nuk do të zbatohen në rast transferimi të kuotave nga një ortak tek një shoqeri e cila ndodhet nën kontrollin e këtij ortakë ose në rast transferimi nga një ortak tek një pasardhës ose pasardhës i drejtpërdrejtë i tij ose tek bashkeshorti.

7.7 Dispozitat e nëneve 7.1- 7.6 , nuk do të zbatohen në rast transferimi të bërë në favor të ortakëve të tjerë. Megjithatë, në këtë rast transferimi duhet të komunikohet fillimisht me shkrim ortakëve të tjerë. Të gjitha njoftimet sipas këtij neni duhet të dërgohen edhe Shoqerise.

Neni 8 - Rritja E Kapitalit

8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të rrisë kapitalin e shoqerise, në përputhje me kuorumin e përcaktuar në nenin 12 të këtij Statuti.

8.2 Në rast të një rritje të kapitalit, ortakët kanë të drejtë të nënshtrohen të kuotave nëpërmjet kontributit në natyrë ose në të holla, në proporcion me përqindjen që zotërojnë në kapitalin e shoqerise.

8.2 Ne rast te nje rritje te kapitalit, ortakët kane te drejte te nenshkrimt te kuotave nepermjet kontributit ne natyre ose ne te holla, ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitali e shoqerise.

8.3 Nese ndonje nga ortakët refuzoje te drejten nenshkrimt, kapitali mund te nenshkruhet nga ortakët e tjeter. Ne kete rast, ortakët e tjere mund te ushtroje te drejten e tyre per nenshkrimin e kapitalit ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitalin e shoqerise.

Neni 9 - Zvogelimi i Kapitalit

9.1 Asambleja e pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 12 te ketij Statuti. Ne çdo rast, kapitali nuk mund te reduktohet nen vleren minimale te percaktuar me ligj.

9.2 Ortakët perballen me uljen e kapitalit te shoqerise ne proporcion me aksionet e zoteruara nga secili prej tyre ne kompani.

Neni 10 - Certifikata e pjesemarrjes

10.1 Secili nga ortakët gezon te drejten nje certifikate ne lidhje me perqindjen ne pjesen qe gezon ne kapitalin e shoqerise. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotata e mbajtura se bashku nga disa Ortakë dhe shperndarja e certifikates per perfaqesuesit e perbashket e anetareve do te konsiderohet e dhene ne interes te te gjithë ortakëve, ne perputhje me dispozitat e ligjit.

TITULLI IV

ORGANET E SHOQERISE

Neni 11 - Organet e Shoqerise

11.1 Organet e Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme;
- 2) Administratori.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

1) Asambleja e Pergjithshme

11.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i Shoqerise dhe perbehet nga te gjithë Ortakët e Shoqerise.

11.2 Çdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme per te shprehur mendimin e tij dhe te votoje ne baze te kuotave qe zoteron.

11.3 Ortaku mund te perfaqesohet nga nje person tjeter, jo domosdoshmerisht Ortak/ e, me ate te nje Prokure te Posacme. Ne çdo rast, kjo Prokure e Posacme mund te jepet vetem per nje Mbledhje te caktuar te Asamblese se Pergjithshme, dhe do te jete e vlefshme edhe per mbledhjet pasardhese me te njejtin rend dite. Administratorët nuk mund te perfaqesojne Ortakun ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

11.4 Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet ne nje vend te ndryshem nga selia e Shoqerise, ne Republikën e Shqiperise ose ne Ballkan apo jashte vendit.

11.5 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori, sipas nevojave dhe interesave te Shoqerise ose nese kerkohe nga legjislacioni ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme mund te thirret edhe nga cdo Ortak qe zoteron te pakten 10% (dhjete per qind) te pjeses se kapitalit. Ne çdo rast, Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda javes se fundit te muajit Maj, ne menyre qe te diskutoje, te shqyrtoje dhe te miratoje bilancin vjetor te vitit te kaluar fiskal. Mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme, do te mbahet brenda tre muajve nga dita e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar per te diskutuar planin e biznesit dhe çeshtje te tjera.

11.6 Njoftimi per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme do te behet me leter rekomande me njoftim marrjeje, dhe do te dergohet ne adresat e Ortakëve te shoqerise te regjistruara ne Regjistrin e Ortakëve, ose me poste elektronike ne adresat e Ortakëve, ose me poste tek Ortakët se paku 21 (njezet e nje) dite perpara dates se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

11.7 Njoftimi duhet te permbaje informacion mbi ceshtjet qe do te diskutohen ne rendin e dites dhe mbi te cilat do te merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrjes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menyra e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuar nga legjislacioni ne fuqi.

11.8 Asambleja e Pergjithshme do te konsiderohet e mbledhur rregullisht edhe nese nuk ka ndjekur te gjitha formalitetet e thirrjes, nese te gjithë Ortakët qe perfaqesojne pjesen e tere kapitalit te shoqerise jane te pranishem ne mbledhje apo te perfaqesuar nga nje perfaqesues me prokure te posacme, dhe shprehen dakort per te zhvilluar mbledhjen e asamblese pavaresisht parregullsive ne thirrjen e saj.

11.9 Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet edhe me pjesemarrjen e njerezve ne vende te ndryshme, dhe mund te mbahet permes telekonferences apo videokonferences, ose mjete te tjera te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjitha pjesemarrjesit te mund te identifikohen dhe t'i jepet mundesia per te marre pjese ne diskutimet dhe per te marre pjese ne to.

11.10 Asambleja e Pergjithshme kryesohet nga Kryetari i cili emerohet nga radhet e Ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje. Nese prezenca e nje noteri publik nuk eshte e nevojshme, Asambleja e Pergjithshme do te emeruje nje sekretar, i cili nuk duhet te jete domosdoshmerisht nje nga Ortaket.

11.11 Kryetari i Mbledhjes ka kompetenca te plota per te kontrolluar prokurat e posacme dhe rregullsine e tyre, te drejten e Ortakeve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, si dhe per te percaktuar nese Mbledhja eshte thirrur rregullisht dhe nese kuorumi i nevojshem per marrjen e Vendimeve te vlefshme eshte arritur. Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe per te percaktuar metodat dhe procedurat e votimit.

11.12 Ne rast se Shoqeria ka vetem nje Ortak qe ka fituar Kuotat e Ortakeve te tjere me ane te nje procesi ligjor dhe zoteron tere kapitalin e shoqerise, vendimet e Ortakut te vetem do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen.

NENI 12- Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

12.1 Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket e shoqerise qe zoterojne me shume se 75% (shtadhjete e pese perqind) te Kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30 (tridhjetë) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme merren me voten pro te shumices se ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

12.2 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te zakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) percaktimin e politikave tregtare;
- (b) emerimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- (c) emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- (d) miratimin e shperblimeve per personat per permendur ne paragrafet (b) dhe (c);
- (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (f) monitorimin dhe mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori;
- (g) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne proceset gjyqesore ndaj Administratorit;
- (h) cdo ceshtje tjeter te percaktuar nga ligji apo statuti.

12.3 Ne rast vendimesh te jashtezakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket qe zoterojne me shume se 75% (shtatedhjetë e pese perqind) te kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30 (tridhjetë) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e jashtezakonshme merren me voten pro te te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

12.4 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te jashtezakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) ndryshimi apo plotesimi i Statutit te Shoqerise;
- (b) zmadhimi apo zvogelimi i kapitalit ose krijimin apo emetimin e aksioneve te reja ose garancive te tjera ose dhenien e cdo te drejte per nenshkrimin apo konvertimin e cdo instrumenti ne aksione apo garanci;
- (c) shperndarjen e fitimeve vjetore nepermjet dividenteve dhe akordimin e aksioneve ne vend te dividenteve;
- (d) riorganizimin, shperndarjen, transformimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, likuidimin apo prishjen e shoqerise si edhe riorganizimin e shoqerise ne nje forme tjeter;
- (e) ndermarrjen e cdo veprimi i cili pitet ne menyre te arsyeshme se do te coje ne likuidimin e shoqerise;
- (f) hapjen e nje dege, blerjen apo shitjen e nje dege me ose pa emer;
- (g) marrjen persiper te cdo detyrimi me nje vlere me te larte se 5% (pese perqind) te aktiveve totale te shoqerise sic rezulton nga pasqyrat e fundit financiare te audituara;

NENI 13 - Administratori

13.1 Asambleja e Pergjithshme do te caktojë nje (1) personi fizik si Administrator te shoqerise, i cili mund te jete ortak ose jo dhe qe do te jete pergjegjes per ceshtjet e perditshme te Shoqerise sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe me kete Statut.

Administratori ushtron keto detyra:

- (a) menaxhon te shoqerine duke zbatuar politikat sic percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme;
- (b) sigurohet qe te mbahen librat dhe dokumentet e nevojshme kontabel;
- (c) Mban dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise dhe ja paraqet ate Asamblese se Pergjithshme per miratim se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;

(d) krijon nje sistem paralajmerimi te hershem ne lidhje me zhvillimet qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;

(e) paraqet te dhenat e shoqerise per t'u regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas rastit;

(f) raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te vecante per punen e Shoqerise;

(g) cdo detyre tjeter siç percaktohet me ligj ose Statut.

13.2 Administratori emerohet per nje periudhe 5 (pese) vjecare dhe me te drejte rizgjedhjeje. Ky emerim prodhon efekte ligjore ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

13.3 Shoqeria merr angazhime me nenshkrimin e vetem te administratorit, sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe me kete Statut.

13.4 Administratori i shoqerise ka te drejten dhe detyrimin per te perfaqesuar Shoqerine ne marredheniet me te tretet.

13.5 Asambleja e Pergjithshme emerom si Administrator te shoqerise Marin Gjonaj per nje afat 5- vjecar .

TITULLI V

VITI FINANCIAR, DIVIDENTI

NENI 14 - Viti Financiar

14.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti.

14.2 Perjashtimisht viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit ne QKB dhe perfundon me 31 dhjetor te atij viti.

NENI 15 – Dividentet dhe Kapitalizimi i Fitimeve

15.1 Permes vendimit te asamblese se pergjithshme shoqeria shperndan dividendin ne perputhje me te drejtit perkatese te ortakeve, nese:

a) aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimin e saj;

b) shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te paguar detyrimet qe duhet te jene te pagueshme brenda 12 muajsh.

15.2 Kapitalizimi i Fitimeve

Me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe ne lidhje me parimet e percaktuara ne nenin 14, te Ligjit 9901, date 14.04.2008 i ndryshuar, Ligj 129, i vitit 2014, administratori mund te vendose per te kapitalizuar fitimet.

TITULLI VI

SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI

NENI 16 - Prishja-Ndarja-Bashkimi

16.1 Shoqeria mund te prishet per shkaqet e parashikuara me ligj. Ne rast te prishjes, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerom nje ose me shume likuidatore duke u percaktuar kompetencat reciproke.

16.2 Shoqeria gjithashtu mund te ndahet ose te bashkohet me ane te nje vendimi te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve.

NENI 17 – Likuidimi

17.1 Ne rast te prishjes shoqeria mund te likuidohet.

17.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerom nje ose me shume likuidatore i cili do te hartoje raportin perfundimtar mbi aktivet dhe pasivet e shoqerise, si dhe procedurat dhe kohen e duhur per likuidim.

17.3 Ne fund te procedurave te likuidimit, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve do te vendose ne lidhje me bilancin perfundimtar, punen e bere nga likuiduesi dhe te perfundoje procesin e likuidimit.

17.4 Me likuidimin e kreditoreve likuiduesit gjithashtu do te shperndajne aktivet e mbetura te Ortakeve ne proporcion me perqindjen qe ata disponojne.

TITULLI VII

NDRYSHME

NENI 18 - Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Gjuha Shqip konsiderohet si gjuhe e Ortakut.

Çdo mosmarreveshje ose mosmarreveshjet ndermjet ortakeve fillimisht do te zgjidhet ne menyre te brendshme dhe miqesisht ne ete kundert kompetente eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI X. DISPOZITA TE FUNDIT

Ky Statut u hartua ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe dhe Italisht.

Ne deshmi te kesaj, une i nenshkruari Noteri Publik vertetoj nenshkrimin e ortakut te shoqerise perpara meje, qe teksti i ketij akti eshte ne perputhje me vullnetin e tij dhe e nenshkruaj ate vullnetarisht ne pranine time dhe une, noteri publik, vertetoj se sa me lart eshte ne perputhje me ligjin ne fuqi, sot me date 06.02.2018.

ORTAKU I SHOQERISE

Karim Gjorgji
em

NOTERE
Marjeta E. Demollari
NIP: 241606090A
Tel: 0632081560